



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË KULTURËS DHE INOVACIONIT
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
QENDRA E FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK VLORË**

Nr. 95 Prot.

Vlorë, më 30.01.2025

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune

Drejtuar: **DREJTORISË JURIDIKE DHE BURIMEVE NJERËZORE
DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE**

T I R A N Ë

Në zbatim të ligjit nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”; të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”; të vendimit të Këshilli të Ministrave nr. 554, datë 31.7.2019, “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive”; Udhëzimit Nr.759 datë 30.09.2014 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit” urdhër nr.139 datë 26.01.2025 “Për miratimin e strukturës dhe të organikave të qendrave të formimit profesional Publik”

Qendra e Formimit Profesional Publik Vlorë, ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin:

- 1 (një) Përgjegjës sektori të Financës dhe Administrimit për QFPP Vlorë.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për vendin e lirë si vijon:

- të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- të ketë diplomë të studimeve universitare të nivelit “master i shkencave”(ose të barasvlershme), në shkenca ekonomike.
- të ketë të paktën 5 (pesë) vjet përvojë pune në profesion, sipas përkrahjeve në shpalljen për pozicionin përkatës.
- të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.
- Kualifikime, trajnime dhe certifikime të tjera në fushën ekonomike përbëjnë avantazh.

2. Dokumentet e aplikimit

Dosja e aplikimit, e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- letër motivimin për pozicionin;
- jetëshkrimin (CV-në);
- kartën e identitetit;
- diplomën;
- librezën e punës;
- çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV;
- certifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- certifikatën ose dëshminë për gjuhë të huaj nëse ka;
- vërtetimin e gjendjes shëndetësore;
- vërtetimin e gjendjes gjyqësore;
- vërtetimin nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij/saj nuk ka marrë masa disiplinore në fuqi;
- të paktën një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm;
- të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre. Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

Përzgjedhja e kandidatit fitues do të bëhet sipas përkrahjeve të Udhëzimit Nr.759 datë 30.09.204 “Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë menaxhimin e burimeve njerëzore, përbërjen e njësisë së zhvillimit të institucioneve, ofruesve të arsimit dhe formimit profesional dhe zhvillimit të vazhduar profesional të personelit”.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e Qendrës së Formimit Profesional Publik Vlorë, brenda datës 10.02.2025

